

## Ftesë për aplikim për trajnime në sektorin e pemëve dhe perimeve

Organizata “Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës” (IADK), është duke zbatuar projektin “Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës” projekt tre-vjeçar (2020-2022), i përkrahur nga Donatori “Bread for the World” nga Gjermania. Në aktivitetin për trajnime të fermerëve ekzistues në sektorin e pemëve dhe perimeve për vitin 2022 është planifikuar trajnimi i dy (2) grupeve të fermerëve në komunat: **Vushtrri dhe Skënderaj**.

Një ndër objektivat e projektit është përkrahja e fermerëve ekzistues që nuk janë në marrëdhënie pune dhe me gjendje jo të mirë ekonomike, të cilët janë të gatshëm të zgjerojnë aktivitetet në fushën e bujqësisë, dhe që nuk janë përkrahur me grante të mëhershme.

IADK në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me komunat e përfshira në projekt, do të investojë në trajnime për 30 fermerë të cilët merren me kultivimin e pemëve dhe perimeve, të cilët do të përcjellin 7 ditë trajnime teorike dhe praktike në sektorët e lartëcekur. Pas përfundimit të trajnimeve këta fermerë do të ftohen të aplikojnë në skemën e granteve me idetë e tyre inovative që kanë ndikim në krijimin e të hyrave dhe vet-punësim. Gjithsej, do të përkrahen 17 fermerë me grante në vlerë nga **3,000.00 €**, duke bashkëfinancuar me 10 % të vlerës totale të investimeve.

Përparësi do t’u ipet ideve inovative që ndikojnë në uljen e varfërisë, mundësi punësimi, mbrojtjen e mjedisit, zgjerimin e aktiviteteve në sektorin e pemëve dhe perimeve dhe krijimin e të hyrave. Andaj, ftohen fermerët që të aplikojnë për ndjekjen e trajnimeve për pemë dhe perime, të cilët pas përfundimit të trajnimeve, mund të aplikojnë për skemën e granteve të lartëcekura.

### KRITERET QË DUHET PLOTËSUAR FERMERËT PËR TRAJNIME JANË:

- Kandidatët e interesuar duhet të jenë nga komunat: Vushtrri dhe Skënderaj;
- Gatishmëria për të qenë pjesë e trajnimeve;
- Janë të angazhuar në sektorin e pemëve dhe perimeve apo kanë potencial që të angazhohen në këtë sektor;
- Të kenë interes për të aplikuar në skemën e granteve me ide inovative për kultivim të pemëve dhe perimeve;
- Të jenë të interesuara për të filluar një biznes apo për t’u vetëpunësuar;
- Të jenë të papunë.

Aplikacioni mund të merret dhe dorëzohet në:

- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni këtu: <https://biturl.top/iqA7vm>
- Nëpërmjet adresës elektronike: [hasan.cena@iadc.org](mailto:hasan.cena@iadc.org), [sylejman.bunjaku@iadc.org](mailto:sylejman.bunjaku@iadc.org)
- Zyrat e Drejtorive të Bujqësisë në komunat e lartëpërmendura
- Zyrat e IADK-së, me adresë Fshati Sfarçak i Ulët, Nr.11, Vushtrri, Kosovë

Afati për aplikim është i hapur deri me datë **04.02.2022**. Për informata shtesë mund të kontaktoni në **+383 (0) 49 973 211 dhe +383 (0) 44 412 475**.

Sinqerisht,

Zenel Bunjaku  
Drejtor Ekzekutiv